

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tre operacione në Tropojë e Kukës, arrestohen tre persona për armëmbajtje, drogë dhe vjedhje
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/tre-operacione-ne-tropoje-e-kukes-arrestohen-tre-persona-per-armembaj-i106389
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHÀ


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 08:33:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 08:28:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3e8285b43fd307f6f06050cd85abb4039b8fa1812db43c71ab2bc5b16a658d2d
TEKSTI	9a62aaed9c56a4fdf966a5eb780052b532af7765d11449622579e604f85a89e7
PAMJA	cfd22a1d1a424a1362748675248a09fce3747dd4b9221f002df8ebd4d8686b05

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8744f8fd7c27c1d45c463c51bb017edd64693a345f4ebb185d556a9833eb41b8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b28949f398f9c40f36f567d35f036ed2a879d9ccf77f144b0ee032f95e15789d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8744f8fd7c27c1d45c463c51bb017edd64693a345f4ebb185d556a9833eb41b8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

[armëmbajtje](#) në Tr...

[shpetimtare](#) fundit në vend pas arrestit të

[Bushatit / vite më parë](#)

[Shqipërinë në një "udhëkryq"](#)

[ne grepin e 'mashtimit kompiuterik'](#)

[sekuestruan telefonat](#) për skandalin e SHISH.

AKTUALITET

Tre operacione në Tropojë e Kukës, arrestohen tre persona për armëmbajtje, drogë dhe vjedhje

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 10:28



Tre persona janë vënë në pranga këtë të hënë, pas tre operacioneve të ndryshme të zhvilluara në Tropojë dhe Kukës, pasi akuzohen për veprat penale të kultivimit të bimëve narkotike, armëmbajtjes pa leje dhe vjedhje.

Sipas raportimeve të policisë, në pranga ka rënë E. M., 45 vjeç, të cilit iu gjet në banesë një armë zjarri automatike dhe municion luftarak.

Gjithashtu, në pranga ka rënë S. H., 38 vjeç, i cili akuzohet për veprën penale "Kultivim i bimëve narkotike", si dhe "Armëmbajtje pa leje".

Ndërkohë, i arrestuari i fundit është shtetasi I. J., 31 vjeç, i cili akuzohet për veprën penale "Vjedhja", i cili ndërmjet thyerjes ka vjedhur një makinë dhe një lokal.

"Në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, zbardhjen e vjedhjeve dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të autorëve, si dhe për parandalimin dhe goditjen e kultivimit të bimëve narkotike, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Tropojë, në bashkëpunim me strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës, në kuadër të operacionit "Befasia", vunë në pranga shtetasin E. M., 45 vjeç, banues në Markaj, Tropojë.

Në zbatim të vendimit të Gjykatës, gjatë kontrollit në banesë, shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri automatike dhe municion luftarak.

Po në Tropojë, në kuadër të operacionit policor të koduar "Weekend", u arrestua në flagrancë shtetasi S. H., 38 vjeç, për veprat penale "Kultivimi i bimëve narkotike", "Prodhimi, mbajtja pa leje e armëve dhe municionit" dhe "Prodhimi, mbajtja pa leje e armëve të ftohta".

Bazuar në informacionet e siguruar në rrugë operative, shërbimet e Policisë ushtruan kontroll në një zonë të pyllëzuar, në territorin e Njësisë Administrative Tropojë e Vjetër, ku dyshohej se kultivoheshin bimë narkotike.

Shërbimet e Policisë, në momentin e ndërhyrjes, konstatuan shtetasin S. H., 38 vjeç, rreth 50 metra larg një parcele ku ishin kultivuar 42 bimë narkotike kanabis. Nga veprimet hetimore rezultoi se këto bimë dyshohet se ishin kultivuar nga ky shtetas.

Gjatë kontrollit fizik, shtetasi S. H. iu gjet dhe iu sekuestrua një armë zjarri pistoletë me krehër dhe 9 fishekë, ndërsa në banesë iu gjet një armë gjahu, municion, si dhe një armë e ftohtë (thikë).

Ndërkohë, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kukës, si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore, bënë të mundur zbardhjen dhe dokumentimin me prova ligjore të dy rasteve të vjedhjes me thyerje, të një automjeti dhe të një lokali. Në kuadër të operacionit "Hija", në bashkëpunim me shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, u kap shtetasi I. J., 31 vjeç, banues në Krumë, Has.

Ky shtetas, në orët e para të mëngjesit të datës 26.09.2026, ka vjedhur me thyerje një automjet në pronësi të shtetasit R. B., si dhe ka thyer dhe vjedhur në një lokal në pronësi të shtetasit G. M. Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan automjeti i vjedhur, një aparat celular që e kishte vjedhur në lokal, dhe një armë e ftohtë (thikë).

Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Kukës, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Has dhe Komisariatin e Policisë Durrës, po vijojnë punën për zbardhjen dhe dokumentimin edhe të disa vjedhjeve të tjera, të dyshuara të kryera nga ky shtetas në Has dhe Durrës." - njofton policia.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përcjellshëm Kukës. nën venime të mëteishme.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 28 Shtator10:16

[Një murale për turistin e vrarë barbarisht në Shqipëri: Lot, zemërim dhe mall për Miltonin](#)

Nga Gregory Leclerc, NICE MATIN Mallëgjimi i thellë, saudade, ndihej këtë të diel në fushën sportive Thérès...

AKTUALITET 28 Shtator09:55

[Shoqata e Gjyqtarëve refuzon ftesën e Ramës për konsultim për pagat: Presim vendimin e 'Kushtetueses'](#)

Shoqata e Gjyqtarëve të Shqipërisë ka refuzuar ftesën e kryeministrit Rama për të marrë pjesë në tryezë...

AKTUALITET 28 Shtator09:34

[Një klikim, mijëra lekë: Si po bien shqiptarët në grepin e 'mashtrimit kompjuterik'](#)

Gjithçka nisi nga një mesazh në telefon. Gentjana Driza ishte në pritje të një porosisë nga TEMU më 23 maj, kur mori një...

AKTUALITET 28 Shtator09:03

[Skandali i SHISH dhe shkarkimi i Vlora Hysenit, nis mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare](#)

Mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare e thirrur nga Bajram Begaj sapo ka nisur, ku në qendër të diskutimeve prite...

AKTUALITET 28 Shtator08:21

[Këmbimi valutor 28 shtator/ Me sa blihen e shiten sot monedhat e huaja](#)

Në tregun e këmbimit valutor shqiptar, një dollar amerikan do të blihet sot me 80.2 lekë dhe do shitet me 81.2 lekë. Ndërk...

AKTUALITET 28 Shtator08:03

[Arrestimi i Vlora Hysenit, sot do të mbledhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare](#)

Bajram Begaj do të mbledh ditën e sotme Këshillin e Sigurisë Kombëtare, në orën 08:30, në Pallatin e Brigadave. K...

AKTUALITET 28 Shtator08:00

[14.783 ditë ferri: dokumenti sekret që tregonte çfarë ndodhte në burgjet e komunizmit pak para revoltës së Qafë-Barit](#)

Burgjet e komunizmit në Shqipëri nuk ishin thjesht vende vuajtjeje dënimi. Ato ishin makina frike, ku shteti përpiqej të shkatër...

AKTUALITET 28 Shtator07:52

[Zjarr në Gjirokastrë/ Merr flakë makina, digjet edhe një kasolle](#)

Dy vatra zjarri kanë rënë mbrëmjen e kaluar në lagjen "Dunavat" në Gjirokastrë. Një automjet ësh...

AKTUALITET 28 Shtator07:22

[Kthjellime dhe vranësira kalimtare, parashikimi i motit për sot](#)

Sot vendi ynë do të ndikohet nga kushte atmosferike relativisht të qëndrueshme. Moti parashikohet i kthjellët ndërsa përgja...

AKTUALITET 28 Shtator07:18

[Pasqyrë moj pasqyrë! Pse i kemi çmimet kaq të shtrenjta](#)

Çmimet nuk ulen me urdhër, me lista publike apo me portale që krahasojnë etiketat. Ulen kur ekonomia prodhon më shumë, kur buj...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 27 Shtator

[Familja e kërkon prej vitesh/ Emisioni italian ...](#)

Rajmonda Kotorri, e cila u largua në Itali kur ishte vetëm 16 vjeçe dhe humbi kontaktet për vite me radhë me familjen e saj, dyshohe...

AKTUALITET 27 Shtator

[I martuar me një grua ruse, si u kap gafil elba...](#)

Detaje të reja kanë dalë nga operacioni, për kapjen në Rusi të Salvatore alias Shpëtim Aliut në Federatën Ruse, ku ...

AKTUALITET 27 Shtator

[“Je rrezik për sigurinë kombëtare”, Azgan Hakla...](#)

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Azgan Haklaj, është ndaluar nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut në pikën kufitare t&...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video






PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgju në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!





Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.